



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:212666

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05498030

C.nr.844/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË / Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me bashkëpunëtorin profesional Liman Javori, në çështjen juridike të paditësve: E. S., A. S. dhe B. R., të punësuar pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët SHFMU "Asim Vokshi" në fshatin Panorç, Komuna e Malishevës, të cilët i përfaqëson avokat Zahir Hamza nga Prishtina, sipas autorizimeve në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë - shujtave ditore, vlera e kontestit 1,110 €, jashtë shqyrtimit me datë 25.03.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve: E. S., A. S. dhe B. R., të punësuar pranë Shkollës Filllore të Mesme të Ulët SHFMU "Asim Vokshi" në fshatin Panorç, Komuna e Malishevës.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore, t'ua paguajë paditësve si në vijim:

- Paditësit E.S., t'ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 370,00 euro*, për 185 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin 2020-2021 (01.07.2020 – 31.06.2021).
- Paditësit A. S., t'ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 370,00 euro*, për 185 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin 2020-2021 (01.07.2020 – 31.06.2021).
- Paditësit B. R., t'ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 370,00 euro*, për 185 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin 2020-2021 (01.07.2020 – 31.06.2021).

Të gjitha shumatat e lartëcekura, detyrohet e paditura që paditësve të iu paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet që nga dita e paraqitjes së padisë dt.18.08.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim që paditësve t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 228.00 euro, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar **REFUZOHET**.

A r s y e t i m

Paditësit E. S., A. S. dhe B. R., të punësuar pranë Shkollës Fillore të Mesme të Ulët SHFMU "Asim Vokshi" në fshatin Panorç, Komuna e Malishevës, të cilët i përfaqëson av. Zahir Hamza nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me dt. 18.08.2021, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim për shujtat ditore të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. Zahir Hamza, kanë bërë precizimin e padisë përmes parashtrësës së dt.05.12.2023, duke deklaruar që paditësit kërkojnë të paguhen në emër të shujtave ditore, për paditësen E. S., për periudhën 2020/2021, për 185 ditë pune shumë prej 370 euro, për paditësin A. S., për periudhën 2020/2021, për 185 ditë pune shumë prej 370 euro, për paditësin B. R., për periudhën 2020/2021, për 185 ditë pune shumë prej 370 euro, pra për secilin paditës shumë prej 2 euro, sipas vërtetimeve të lëshuara nga shkolla, të gjitha këto me kamatë prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në vlerën prej 260 € euro në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 260 euro për seancë, si dhe 20 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata pas pranimit të parashtrësës për precizim të kërkespadiës, ia ka dërguar për njoftim të paditurës e cila me dt.11.03.2024 ka bërë përgjigje në padi – precizim duke e kontestuar vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datën 21.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate, po ashtu MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e Komunave me datën 22.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kësaj kontrate kolektive, kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qenë e lidhur nga kjo Ministri, Komuna e Malishevës – DKA, e lidhur me këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet të palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë Dega Malishevë që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Themelësia e kërkesëpadiës del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi me nr.prot.361/21 të datës 12.07.2021, për paditësin B. R., vërtetimi me nr.prot.... të dt.12.07.2021 për paditësin A. S., dhe vërtetimi me nr.prot.346/21 të dt.12.07.2021, për paditësin E. S., të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Asim Vokshi" fshati Panorç Komuna e Malishevës, nga të cilat vërtetohet se paditësit janë në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënës në këtë shkollë, si dhe nga të njëjtit vërtetohet vijueshmëria në punë e paditësve për vitin 2020/2021 (01.07.2020-31.06.2021), periudhë kjo për të cilën të gjithë paditësit e lartëcekur kërkojnë kompensimin e shujtave të ushqimit për 185 ditë pune për secilin, të cilave prova gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo*

organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në punë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Asim Vokshi” në fshatin Panorc, Komuna e Malishevës, ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin në emër të kompensimit të shujtave ditore.

Sipas nenit 35 par.7 dhe 9 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 *”Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Sipas dispozitës në fjalë paditësve u takojnë shpenzimet e ushqimit.

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 90 par. 5 e që përcakton se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”,* e që nënkupton detyrimin e punëdhënësit përkatësisht të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që prodhon efekt juridik për punëdhënësit që kanë të punësuar, sepse të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë dhe e paditura është punëdhënës i paditësve prandaj detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Njëkohësisht, meqenëse u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar vlerën e borxhit sa i përket kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, megjithatë për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”,* e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në precizim nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare përveç që është e kontestuar e drejta e kompensimit të shujtave ditore si e pa bazuar në kontratën kolektive, andaj gjykata duke interpretuar të njëjtën me dispozitat e nenit 396 par.2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”,* në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi- precizim, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës sa i përket legjitimitetit të saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë*

dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkepËtjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkon realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive.

Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për periudhën 2020/2021 (01.07.2020 – 31.06.2021), paditësit kanë gjithësej nga 185 ditë pune secili prej tyre, dhe atyre iu takojnë shpenzime të ushqimit për çdo ditë pune nga 2€uro (185 x 2=370.00€uro) e që është shuma prej 370.00 €uro për secilin paditës. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve t’iu paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 18.08.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 208 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20 euro, ndërsa shuma mbi vlerën e aprovuar për padi, konkretisht shuma prej 52 euro për përpilimin e padis është refuzuar duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve numri tarifor 6, si dhe shuma prej 270 e kërkuar për seancë u refuzua nga gjykata për faktin e nxjerrjes së aktgjykimit jashtë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i’u referuar dispozitës së nenit 152 te LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 parg.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.844/21 dt.25.03.2024

**Gjyqtarja
Hatixhe Begaj**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.